

FEHMI PUSHKOLLI**NGA PEZULLIMI I PARLAMENTIT TË KOSOVËS
NË PËRDPJEKJET PËR KONSTITUIMIN E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS (1990)***

Mbretëria e Jugosllavisë, e krijuar me Paqen e Versajës në vitin 1919, si një miniperandori për të mbrojtur interesat e disa shteteve të mëdha, gjatë gjithë ekzistencës së saj, pra edhe si RSF e Jugosllavisë, deri në shthurjen e saj në vitin 1991, u ballafaqua me probleme të mëdha. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore ajo i përballoi këto probleme falë interesave të Fuqive të Mëdha dhe ndarjes së botës në sfera të interesit dhe në blloqe. Josip Broz Tito, kryetar i Jugosllavisë, arriti të ruajë shtetin me lojën e bashkekzistencës paqësore dhe pa u angazhuar në blloqe. Mirëpo, problemet nuk ishin zgjidhur, vetëm ishin gulfatur dhe shtyrë për më vonë. Më të rëndat ishin: Bosnja dhe Hercegovina si subjekt politik dhe etnik, ndarja e saj në mes të Serbisë dhe të Kroacisë, si dhe problemi i shqiptarëve në Jugosllavi, në përgjithësi dhe ai i shqiptarëve të Kosovës, në veçanti.

Problemi i pazgjidhur në zonën jugore e kishte qendrën në Kosovë. Ai ishte lidhur drejtpërdrejt me Shqipërinë, Serbinë dhe Maqedoninë, por edhe me interesat e Bullgarisë, Greqisë dhe të Turqisë. Ky problem, megjithëse në fokus, mbeti i pazgjidhur gjatë gjithë shek.XX. Vetëm në fund të këtij shekulli mori përmasa të një lufte ndërkombëtare.

Shqiptarët, gjatë një shekulli, që nga viti 1912 e deri në vitin 1999, zhvilluan shumë luftëra çlirimtare. Në këtë periudhë, kryesisht kanë dominuar dy alternativa politike: ajo për bashkim me Shqipërinë, si dhe shpallja e Republikës së Kosovës, shtet i pavarur, me të drejtën e vetëvendosjes. Pra, alternativa për shpalljen e Republikës së Kosovës ishte parakusht që të fitohej e drejta për shkëputje nga Jugosllavia në

* Kumtesë e përgatitur për projektin “Kosova dhe viset e tjera shqiptare në periudhën pas Luftës së Ftohtë”.

bazë të drejtës për vetëvendosje, të cilën e gëzonin republikat e tjera që përbënin Shtetin Federativ të Jugosllavisë.

Shqiptarët e Kosovës ishin të bindur se një ditë do të çlirohen nga Serbia dhe Jugosllavia. Bazë e gjithë kësaj duhej të shërbente Kushtetuta e Kosovës, e miratuar në vitin 1974 dhe Kushtetuta e Jugosllavisë, e miratuar po në të njëjtin vit, në të cilën KSA e Kosovës përcaktohej si element kushtetues i RSF të Jugosllavisë. Mirëpo shqiptarët nuk ishin unikë për rrugën dhe mënyrën e sendërtimit të këtij qëllimi. Tjetër pengesë ishte Serbia, e cila, e pakënaqur me ndryshimet e bëra në Kushtetutën e Jugosllavisë nuk do të lejonte shkëputjen e Kosovës nga Serbia dhe formimin e Republikës së Kosovës. Në frymën e kësaj politike, që nga viti 1986 deri në vitin 1990, doli në skenë politika serbomadhe e S. Millosheviqit. Aspiratat serbe u përqendruan në zhdukjen e autonomisë së Kosovës dhe në mohimin e të gjitha të drejtave kombëtare që gëzonin shqiptarët deri në atë kohë. S. Millosheviqi u kishte premtuar forcave nacionaliste serbe dhe kishte marrë përkrahjen edhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë, që, në frymën e Memorandumit të saj, të zgjidhej çështja e Kosovës dhe e shqiptarëve¹. Pengesë kryesore për realizimin e aspiratave serbomëdha ishin Kushtetuta e Jugosllavisë dhe Kushtetuta e Kosovës të vitit 1974. S. Millosheviqi, aspiratat e hapura nacionaliste i shprehu më 24 prill të vitit 1986, në fjalimin e tij para serbëve në Fushë-Kosovë ku deklaroi: “Askush nuk duhet të guxojë t’ju rrahë!”². Puna, sipas S. Millosheviqit, duhej kryer në mënyrë “legale ose jolegale, kushtetuese ose jokushtetuese. Serbia do ta shtrijë pushtetin edhe në Kosovë”³. Formalisht, KQ i LKS-së dhe Kuvendi i Serbisë kërkuan pëlqimin e KK të LK të Kosovës dhe të Kuvendit të Kosovës, por, edhe pa miratimin e tyre, ndryshimet kushtetuese do të bëheshin. Kjo u vërtetua me rastin e shpalljes së diskutimeve për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës dhe të Kushtetutës së Serbisë. Populli i Kosovës u deklarua kundër ndryshimeve të parimeve mbi të cilat ishte ngritur Kushtetuta e Kosovës dhe e Jugosllavisë. Por, *de facto*, Serbia e kishte shtrirë pushtetin në Kosovë dhe me masa të jashtëzakonshme i mbante shqiptarët nën presion. Madje,

¹ F. Pushkolli, *Mbrojtja Kombëtare Shqiptare e Kosovës 1878-1990*, Prishtinë, 1991, f.174. Memorandumi i ASHAS nuk ishte asgjë tjetër vetëm një riaktivizim i planeve të mëparshme të V. Çubrilloviq dhe të tjerëve.

² N. Malcolm, *Kosova, një histori e shkurtër*, Prishtinë, 2001, f.356.

³ F. Pushkolli, *vep. e përm.*

nuk ngurronte edhe në përdorimin e dhunës si nga policia e saj, ashtu edhe nga policia e bashkuar e Jugosllavisë. Disa republika parashikuan se fryma serbomadhe do të shtrihej edhe në vendet e tyre. Ato filluan të organizohen për demokratizimin e vendeve të tyre dhe pa ngurrim u shprehën kundër prirjeve të Serbisë për centralizimin e vendit dhe mbajtjen e tij nën tutelën e Armatës së Jugosllavisë, që me shumicë absolute, kontrollohej nga serbët dhe Serbia. Larja e hesapeve të vjetra dhe të reja, të krijuara nga Serbia, në krye të së cilës tanimë ishte S. Millosheviqi, kishin marrë jetë. Strukturat politike dhe shtetërore shqiptare të Kosovës dhe në veçanti Azem Vllasi dhe Kaqusha Jashari, kryetare e KK të LK të Kosovës ndjenë se kanosej rreziku i zhdukjes së autonomisë së Kosovës. Por objektivisht ata nuk kishin mundësi të pengonin strukturat shtetërore të Serbisë, të cilat punonin me çdo lloj mjeti për rrënimin e autonomisë së Kosovës. Strukturat kombëtare shqiptare ende nuk ishin konsoliduar që t'i dilnin në ndihmë, ndaj hezitonin që çështjen e Kosovës ta zgjidhnin kuadrot komunistë. Mirëpo, rreziku ishte shumë i madh dhe objektivisht krijonte mundësi për bashkimin e të gjitha forcave shqiptare për të arritur qëllimin madhor, çlirimin nga robëria shekullore serbe. Për këtë arsye u fillua me koordinimin e aksioneve legale publike, me intensifikimin e aktiviteteve të organizatave, grupeve dhe partive ilegale.

Populli shqiptar gjatë diskutimeve për ndryshime kushtetuese u orientua, me të drejtë, për mbrojtjen e interesave kombëtare. Kjo dëshmohej nga të dhënat për pjesëmarrjen në diskutime për ndryshimet kushtetuese, në të cilat u deklaruan se shqiptarët janë për ruajtjen e autonomisë së Kosovës, që ajo të jetë element përbërës i Federatës Jugosllave⁴. Mirëpo, në Serbi u deklarua se Krahinë e Kosovës duhet të jetë vetëm pjesë përbërëse e Serbisë. Problemi nuk mund të zgjidhej në mënyrë legale dhe pas kësaj, Serbia planifikoi përdorimin e dhunës. Minatorët e Staritërgut vendosën që të organizonin protestën e tyre dhe marshuan drejt Prishtinës. Rrugës iu bashkuan edhe punëtorët e ndërmarrjeve të tjera të Mitrovicës dhe të Vushtrisë si dhe shumë fshatarë të fshatrave gjatë aksit rrugor Mitrovicë-Prishtinë. Protestës iu bashkangjiten edhe punëtorë, fshatarë dhe qytetarë nga të gjitha qendrat e

⁴ *Dokumente në Arkivin e LSPP të Kosovës*, 1988. Në tubime popullore u shtruan kërkesa që, jo vetëm të ruhej autonomia e Kosovës, por edhe që Kosova të bëhej republikë. Procesverbalet iu dorëzuan Konferencës Krahinore të LSPP-së, si bartëse e organizimit të diskutimeve kushtetuese.

Kosovës. Kështu në Prishtinë u gjetën rreth 600 000 protestues. Protestat filluan më 17 nëntor të vitit 1998 dhe zgjatën disa ditë. Ato treguan forcën dhe vendosmërinë e shqiptarëve të Kosovës, edhe pse përfunduan pa sukses.

Në këtë kohë, Millosheviqi vendosi të bëjë ndryshime në kuadrin drejtues të Kryesisë së LK të Kosovës dhe në të gjitha institucionet e rëndësishme shtetërore.

Ndryshimet e bëra me presione politike dhe me dhunë filluan në Sigurimin Shtetëror të Kosovës. Me këtë u hap rruga për të burgosur të gjithë ata që u vlerësuan se në të ardhmen mund të paraqisnin pengesa në sendërtimin e synimeve të Serbisë për shthurjen e rrënimin e autonomisë së Kosovës. Për këtë qëllim Rrahman Morina, sekretar i SPB të Kosovës u emërua Kryetar i KK të LK të Kosovës. Më parë, në një mbledhje të fshehtë midis tij dhe Millosheviqit, u morën vesh që të bëheshin të gjitha ndryshimet që synonte Serbia. Në të njëjtën kohë u larguan nga pozita të rëndësishme funksionare të shumtë dhe filluan përgatitjet për miratimin e ndryshimeve kushtetuese.

Përgatitjet që po bënte Serbia për rrënimin e autonomisë së Kosovës nuk mbetën pa u hetuar nga minatorët e Staritërgut. Për këtë arsye ata ndërmorën hapin ekstrem, u ngujuan në galeritë nëntokësore, nga ku shtruan kërkesat e tyre, duke lajmëruar gjithë opinionin se nuk do të dilnin mbi tokë derisa të plotësoheshin kërkesat e tyre. Në thelb ato përbënin një program për ruajtjen e autonomisë së Kosovës, të hartuar në 10 pika. Programi u përkrah nga të gjithë qytetarët shqiptarë të Kosovës. Aty kërkohej që të ruheshin parimet themelore të Kushtetutës së vitit 1974; të pezullohej Projektligji për pensionin e parakohshëm të arsimtarëve; të jepte dorëheqjen Rr. Morina, A. Shukriu dhe H. Azemi; të shkonte për bisedime në galeri S. Shuvar, S. Millosheviq dhe nga një anëtar, përfaqësues i Komiteteve Qendrore dhe i Vojvodinës; të jepeshin arsyet pse u larguan nga funksionet Azem Vllasi dhe Kaqusha Jashari. Gjithashtu u shtrua edhe kërkesa që “Fati i shqiptarëve në Kosovë dhe Jugosllavi të shtrohej në Kombet e Bashkuara”⁵. Udhëheqja shtetërore dhe partiake e Jugosllavisë i refuzoi të gjitha kërkesat e minatorëve dhe shpalli masa të posaçme, të cilat ishin masa të dhunës dhe të terrorit mbi popullsinë shqiptare të Kosovës. U morën masa të posaçme nga

⁵ Programi i minatorëve u botua në të gjitha mjetet e informimit të Kosovës dhe jashtë vendit, në shkurt të vitit 1989.

Jugosllavia dhe aleatët e saj që çështja e Kosovës të mos shtrohej në OKB. Miratimi i masave të posaçme të RSFJ-së i lejoi Serbisë veprim të lirë në Kosovë. Në këtë kohë u izoluan dhe qindra intelektualë dhe udhëheqës ekonomikopolitikë të Kosovës. Serbia burgosi A. Vllasin, A. Abrashin, drejtorin e Kombinatit Trepça bashkë me strukturat udhëheqëse të Kombinatit dhe Lazër Krasniqin, drejtor i Elektro Kosovës. Filloi edhe një proces politik i montuar si shumë të tillë të organizuar më parë. Kësaj radhe i gjithë opinioni në Kosovë, por edhe në Evropë dhe në ShBA tregoi interesim të veçantë. Kjo shihet me rastin e fillimit të procesit gjyqësor në Mitrovicë, të cilin e përcollën 13 ambasadorë të Evropës dhe ai i ShBA-së. Në fund të gjykimit, të burgosurit u liruan si të pafajshëm, sepse Serbia e kishte arritur qëllimin dhe nuk ishte më e interesuar për veprimtarinë e tyre politike. Më 23 mars 1989, pas përgatitjeve të nevojshme, nën masa të posaçme, Serbia thirri mbledhjen e Kuvendit të KSA të Kosovës, ku në rend dite ishin ndryshimet kushtetuese. Aty u paraqitën edhe disa amendamente, të cilat nuk kishin qenë në diskutimin publik në Kosovë. Në mbledhje morën pjesë shumë të ftuar, saqë nuk ishte e qartë se kush ishte delegat. Pas diskutimeve, ku ishte shprehur edhe mospajtimi, u votua dhe u miratuan ndryshimet kushtetuese, me të cilat u rrënua autonomia e Kosovës. Kundër miratimit të tyre votuan vetëm 12 delegatë. Gjatë zhvillimit të punimeve të mbledhjes së Kuvendit Krahinor, ndërtesa ishte e rrethuar me tanke dhe brenda në zyrat e delegatëve ishin vendosur njerëzit e Sigurimit Shtetëror të Serbisë, madje edhe në sallën ku mbahej mbledhja e Kuvendit. Të gjitha rrugët që çonin në ndërtesën e Kuvendit Krahinor ishin të bllokuara me policë dhe tanke. Dhe me të drejtë, kjo kushtetutë u bë e njohur si “Kushtetuta e tankeve” ndaj dhe populli i Kosovës nuk e njohu kurrë. Pas kësaj, Serbia krijoi mundësi që më 28 mars 1989 të miratojë Kushtetutën e Serbisë sipas dëshirës së saj. Kjo ishte fitorja e Serbisë për shthurjen e autonomisë së Kosovës. Ndërsa në Beograd mbaheshin solemnitete, në Prishtinë dhe në Kosovë bëhej qëndresë e përgjithshme popullore, ku policia derdhi edhe njëherë gjakun e popullit shqiptar. Shqiptarët, edhe njëherë vërtetuan se kurrë nuk do të pranonin të jetonin në robërinë e Serbisë.

Pakënaqësinë e popullit shqiptar e shfrytëzuan grupe të ndryshme për t’u organizuar në mbrojtje të interesave kombëtare. Me qëllim që mbrojtja të bëhej në mënyrë kolektive u vendos që të formohej Lidhja Demokratike e Kosovës. Kuvendi Themelues u mbajt në Prishtinë, më 23

dhjetor të vitit 1989. Ai zgjodhi Kryesinë e LDK-së me kryetar dr. Ibrahim Rugovën dhe miratoi programin e LDK-së në 5 pika⁶. Në të nuk u deklarua shpallja e Republikës së Kosovës dhe as shkëputja nga Jugosllavia. Ai kërkoi që në rindërtimin e Jugosllavisë në formë të federatës ose të konfederatës, Kosova të jetë element me të drejta të barabarta, ku qytetarët e Kosovës të vendosin lirisht. Pra, LDK ishte për Jugosllavi demokratike, federative, socialiste dhe për reformën e sistemit politik. Programi përcaktonte se zgjidhja e problemeve për Kosovën dhe shqiptarët ishte rruga paqësore. Mbi këtë bazë ishte ngritur pacifizmi dhe durimi edhe në pakufi. Ky orientim më vonë u bë një nga pengesat në mobilizimin e plotë të popullit për luftë të armatosur çlirimtare. LDK ishte organizata e parë politike legale shqiptare e regjistruar në Ministrinë e Drejtësisë të Qeverisë së Jugosllavisë. Gjatë vitit 1990 gati të gjithë shqiptarët ishin anëtarësuar në LDK, edhe pse shumë prej tyre ishin anëtarë të organizatave ilegale. Ata e shfrytëzuan atë për veprimtari subversive ndaj pushtetit dhe vetë shtetit të Jugosllavisë.

Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës ishte krijuar dhe vepronte në ilegalitet. Në aspektin programor ishte orientuar për formimin e Republikës së Kosovës në kuadër të Jugosllavisë. Sipas tyre, nga që shqiptarët ishin për nga numri populli i tretë në Jugosllavi ishte më e lehtë të luftohej dhe të formohej Republika e Kosovës dhe pastaj, në bazë të së drejtës për vetëvendosje, të bëhej shkëputja nga Jugosllavia. Me orientim politik, lëvizja ishte një parti e majtë e përcaktuar për ndërtimin e socializmit duke u mbështetur te Shqipëria. Enver Hoxha pranohej udhëheqës i pakontestueshëm i gjithë popullit shqiptar, pavarësisht se ku jetonte. Në programin e saj ishte përcaktuar që qëllimi të arrihej edhe me luftë, nëse kjo nuk arrihej në mënyrë paqësore. LPRK ua dërgoi strukturave shtetërore kërkesat e saj programore, në nivel të Federatës Jugosllave, republikave dhe udhëheqjes së Kosovës. Ajo i ftonte ato që t'u jepnin përkrahje, sepse nuk shkonte në dëm të asnjë populli në Jugosllavi dhe se me këtë shqiptarët do të fitonin barazinë e merituar si edhe popujt e tjerë të Jugosllavisë. Për programin e LPRK ishte informuar edhe Shqipëria, si edhe shumë shtete të Evropës dhe institucione ndërkombëtare. Njohja më e rëndësishme dhe më mirë e

⁶ *Arkivi i LDK-së*, Prishtinë, 1989. Programi më vonë është botuar edhe në mjetet e informimit të kohës. Dokumentin e ka botuar edhe: F. Pushkollli, *vep. e përm.*, f.183-187.

organizuar është bërë më 6 janar të vitit 1990 në Jugosllavi, kurse në Kosovë për kërkesat e LPRK-së populli gati në tërësi ishte i njoftuar edhe më herët. LPRK-ja vlerësoi se “Konstituimi i Republikës është në pajtim me Kartën e OKB-së dhe Vendimet e Helsinkit dhe nuk sjell kurrëfarë rreziku për paqen në Ballkan. Përkundrazi, duke i njohur popullit shqiptar këtë të drejtë, paqja në Ballkan do të stabilizohet edhe më shumë”⁷. LPRK-ja kërkoi dialog në mes të popullit shqiptar dhe qeverisë së Jugosllavisë dhe të drejtën për vetëvendosje. Përsa i përket idesë për formimin e Republikës së Kosovës me të gjitha trojet etnike të ndara në mes të Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, kjo ide sa ishte e pranuar nga të gjithë shqiptarët, aq ishte edhe e vështirë për sendërtim. Ky program është synim i shqiptarëve edhe në ditët e sotme. Mirëpo, si në nivel të Jugosllavisë, ashtu edhe republikat e tjera në Jugosllavi nuk ishin të gatshme që të zhvillonin dialog me shqiptarët dhe të pranonin të drejtën e tyre për vetëvendosje. Serbia në muajt e parë të vitit 1990 u mundua që me dredhi të paqtojë popullin shqiptar. Ajo liroi nga burgjet një numër të madh të rinjsh, edhe të dënuar të tjerë nën moshën mesatare, të cilët ishin dënuar me burgime të rënda. U liruan edhe disa të burgosur politikë që kishin vuajtur nëpër burgje nga dhjetë e deri në pesëmbëdhjetë vjet si: Adem Demaçi, Kadri Osmani, Ukshin Hoti, Mehë Uka dhe të tjerë. Ata përbënin pjesën më radikale dhe më të vendosur për çlirim nga robëria shekullore serbe. Pasi dolën nga burgjet, ata e shtuan aktivitetin e tyre politik për mobilizimin e popullit në intensifikimin e luftës çlirimtare.

Gjatë vitit 1990, zgjidhja e çështjes së Kosovës në planin e brendshëm u përqendrua në fitoren e të drejtës së vetëvendosjes, zgjedhjeve të lira dhe demokratike, lirisë së mendimit dhe të shprehjes, në heqjen e censurës, lirim të burgosurve politikë, ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe kombëtar të shqiptarëve etj. Njëkohësisht, shqiptarët e kuptuan se e kishin të pamundur të zgjidhnin çështjen e Kosovës vetëm me forcat e tyre. Për këtë arsye, gjatë kësaj kohe ata u impenjuan për

⁷ LPRK-ja kërkoi sendërtimin e këtyre të drejtave kombëtare dhe demokratike:

1. Popullit shqiptar në Jugosllavi t'i njihet statusi i kombit.
2. Konstituimi i Republikës së Kosovës në kuadër të RSFJ-së, ku do të përfshihen trojet e banuara në shumicë me shqiptarë nën Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi. Dokumenti është botuar në tërësi nga: F. Pushkolli, *vep. e përm.*, f.172 e vijim.

internacionalizimin e saj. Opinioni botëror u njoh me të gjitha problemet dhe rrezikun që i kanosej popullit shqiptar nga regjimi policor serb. Përkrahja e opinionit ndërkombëtar, e shprehur përmes Parlamentit Evropian, Senatit dhe Kongresit amerikan dhe qeverive të tjera, kishte rëndësi për Kosovën. Ajo i hapte rrugë fitores së lirisë dhe barazisë së popullit shqiptar me popujt e tjerë të Jugosllavisë dhe të Ballkanit. Gjithashtu, Evropa kuptoi se pa zgjidhjen e problemit të Kosovës nuk ka zgjidhje të problemeve në këtë rajon. Kjo u kuptua edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, kur Ramiz Alia, kryetar i Shqipërisë, shtroi nevojën e zgjidhjes së problemit të Kosovës dhe nga të pranishmit u prit me duartrokitje që ishte dhe një shenjë e përkrahjes. Për të gjitha këto duhet falenderuar në radhë të parë qëndresa, gjakderdhja dhe lufta heroike e rinisë shqiptare, që gjoksin e vet e vuri para plumbave të policisë serbe.

Gjatë janarit dhe shkurtit të vitit 1990 vijuan demonstratat ku kërkoheshin dorëheqja e udhëheqjes krahinore me Rrahman Morinën në krye dhe heqja e gjendjes së jashtëzakonshme. Në këtë kohë u vranë së paku 14 veta⁸. Gjatë muajit mars dhe prill të vitit 1990 ndodhi helmimi i më se 7 000 nxënësve shqiptarë nëpër shkolla. Helmimi ishte bërë me substancën e armëve kimike të “sarinit”. Në vitin 1995 u vërtetua se Jugosllavia ishte prodhuese e kësaj lënde kimike⁹. Shqiptarët, në shenjë hakmarrjeje, filluan të sulmonin serbët, kryesisht policët. Serbia, për të qetësuar situatën, dërgoi në Kosovë forca të reja policore. Te shqiptarët u shtua edhe më shumë pakënaqësia dhe vendosmëria për mobilizim të përbashkët kundër robërisë serbe.

Gjatë vitit 1990 Kuvendi Federativ kërkoi të bëhej ndryshimi i Kushtetutës së Jugosllavisë. Kuvendi i Serbisë dëshironte t’i shfrytëzonte ato për t’i hequr KSA të Kosovës të drejtën e elementit kushtetues të Federatës Jugosllave. Ky ishte edhe një hap më afër shturjes në tërësi të autonomisë së Kosovës. Frika dhe pakënaqësia e popullit shqiptar u shtua edhe më shumë. Represionet e Serbisë u shtuan. Gjaku i shqiptarëve filloi të derdhej sërish. Vriteshin njerëzit në rrugë, në shkollë, në ushtri dhe kudo. Faji i tyre i vetëm ishte se ishin shqiptarë.

Lidhja e Shoqatave të Historianëve të Kosovës duke analizuar gjendjen në Kosovë dhe synimet e Serbisë erdhi në përfundimin se,

⁸ *Dokumenti i KMLDNJ*, Prishtinë, mars 1990.

⁹ Raporti i KS të OKB-së i botuar në mjetet e informimit.

autonomia e Kosovës duhej të mbrohej në bazë të së drejtës të përcaktuar me Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974 dhe se për ndryshimet kushtetuese ishte e nevojshme të jepte pëlqimin Kuvendi i Kosovës. Për këtë arsye vendosën t'u drejtoheshin delegatëve të Kuvendit të Kosovës dhe të Kryesisë së RSFJ-së me një parashtrësë programore. Në të kërkohej që Kuvendi i KSA të Kosovës, në radhë të parë, të bënte shfuqizimin e amendamenteve në Kushtetutën e KSA të Kosovës dhe të Serbisë dhe të mos jepte pëlqimin për ndryshimin e Kushtetutës së Jugosllavisë. Kjo parashtrësë iu dërgua si kërkesë gjithëpopullore, iu dorëzua edhe mjeteve të informimit dhe u botua në trajtë të shkurtuar¹⁰ më 9 prill të vitit 1990. Parashtrësja ishte hartuar në 6 pika¹¹. Populli i Kosovës ishte kundër procedurës për fillimin e ndryshimeve në parimet e Kushtetutës së Jugosllavisë, por Kuvendi i Kosovës, nën presionin e Serbisë dhe të Jugosllavisë e dha pëlqimin. Dihej paraprakisht se kjo do të shkonte në dëm të shqiptarëve dhe të autonomisë së Kosovës.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, në Kuvendin e mbajtur më 14 qershor 1990, miratoi Deklaratën mbi Çështjet Kushtetuese, të cilën e përkrahën të gjithë shqiptarët e Kosovës. Ajo hapi një rrugë të re në historinë e mbrojtjes kombëtare shqiptare dhe përkrahu alternativën që Kosova të ishte subjekt i barabartë në një Federatë-Konfederatë Jugosllave. Kjo paraprakisht do të thotë që Kosova të shpallej Republikë. Në Deklaratë kërkohej që Kuvendi i KSA të Kosovës

¹⁰ *Arkivi i LShH të Kosovës*, nr.1/10, 9 prill 1990.

¹¹ *Po aty*. Ato janë:

1. Opinioni i Jugosllavisë të ngrejë zërin kundër dhunës që po ushtron policia serbe në Kosovë.
2. Që Kryesia e Jugosllavisë të shfuqizojë vendimin për vendosjen e masave të jashtëzakonshme në Kosovë. Ato janë vendosur për popullin shqiptar, sepse për popujt e tjerë në Kosovë nuk vlejnë.
3. Që delegatët e Kuvendit të Kosovës mos të miratojnë vendimin për fillimin e procedurës së ndryshimit të Kushtetutës së Jugosllavisë.
4. Që delegatët e Kuvendit të KSA të Kosovës të shtrojnë çështjen e vendosjes së dualitetit të pushtetit në krahinën e Kosovës.
5. Që delegatët të shtrojnë çështjen e ruajtjes së shëndetit të popullit, të hiqet rrethimi i spitaleve nga policia, të ndalen rrahjet, bastisjet dhe keqtrajtimet e popullit, të cilat janë bërë kënaqësi shpirtërore e policisë serbe në Kosovë.
6. Që delegatët të shtrojnë çështjen e përgjegjësisë individuale dhe kolektive të policisë dhe të funksionarëve për të gjitha keqpërdorimet e bëra në Kosovë dhe në popullin shqiptar.

ta përgatisë dhe ta proklamojë Deklaratën Kushtetuese mbi pozitën e re kushtetuese të Kosovës në rregullimin kushtetues të vendit, në drejtim të barazisë së Kosovës në federatë-konfederatë, si Kosovë e të gjithë qytetarëve, pavarësisht nga kombësia e tyre, në të cilën shqiptarët konsiderohen jo pakicë kombëtare apo kombësi, por KOMB (popull) si në Kosovë, ashtu edhe në Jugosllavi me subjektivitet të barabartë politik, e cila, sipas nevojës mund të fuqizohet edhe me referendum, si akt i vendosjes politike të Kosovës. Ndaj të anulohet vendimi i 23 marsit të vitit 1989 për dhënien e pëlqimit për amendamentet e Kushtetutës së RS të Serbisë, që Kuvendi i Kosovë të mos miratojë më ligjet me “ujdi” me Serbinë, por të miratojë ligje në mënyrë të pavarur dhe të shprehet gatishmëri për përgatitjen e Deklaratës Kushtetuese si institucion ose në formë individuale. Deklarata u miratua në katër pika¹². AShA e Kosovës kërkoi nga historianët e Kosovës që të mbajnë një tubim shkencor, ku mbi bazë shkencore të argumentojë nevoja dhe baza historike si e drejtë e patjetërsueshme; të analizohej e drejta për vetëvendosje, e fituar gjatë Luftës Nacionalçlirimtare e në veçanti, mbi bazën e Konferencës së Bujanit të 31 dhjetorit 1943 dhe të 1 dhe 2 janarit 1944. Lidhja e Shoqatave të Historianëve të Kosovës e mbajti tubimin më 26 qershor 1990 ku morën pjesë historianë, juristë, ekonomistë, politikologë dhe ish-funksionarë të lartë të Kosovës, si: Fadil Hoxha, Xhavit Nimani, Xhevdet Hamza, Halil Fejzullahu, Ramadan Vraniqi dhe të tjerë. Në emër të kryesisë së LDK-së mori pjesë profesor Fehmi Agani. Aty u argumentua dhe u analizua shkencërisht se Kosova i ka të gjitha atributet e nevojshme që të shpallet republikë dhe në bazë të së drejtës së vetëvendosjes të përcaktojë fatin e vet në të ardhmen. Diskutimet u botuan në mjetet e informimit, kurse konkluzionet e miratuara në tubim, si tërësi, u botuan vetëm jashtë Kosovës¹³. Gjatë qershorit të vitit 1990, delegatët shqiptarë, në mbledhjen e Kuvendit u munduan të shtrojnë për shqyrtim disa probleme rreth ndryshimeve kushtetuese, por u penguan nga kryetari i

¹² “Rilindja”, 16 qershor 1990. Deklarata e AShA të Kosovës.

¹³ “Alternativa”, Lubljanë, korrik 1990. Tezat për tubimin shkencor i përgatiti prof.dr. Fehmi Pushkollli, i cili mbajti edhe referatin: “Pse Kosova mund të bëhet republikë në bazë të së drejtës për vetëvendosje”. Pjesë të shkëputura u botuan në “Rilindja”, 27 e 28 qershor 1990 dhe në “Veçerni list” të Zagrebit nga korrespondenti i saj nga Prishtina (Shefki Uka). Konkluzionet e tubimit iu dorëzuan edhe Kuvendit të Kosovës me një akt përcjellës më 27 qershor të vitit 1990, nr.11. Gjatë vitit në vijim konkluzionet u botuan në shumë gazeta edhe jashtë vendit.

Kuvendit të Kosovës dhe delegatët serbë. Megjithatë u miratua vendimi që në 2 korrik 1990 të mbahej një mbledhje e Kuvendit të Kosovës. Kur delegatët shkuan për mbledhje morën informatën se mbledhja e Kuvendit ishte shtyrë për në 5 korrik 1990. Delegatët e Kuvendit të Kosovës, 115 shqiptarë dhe turq, e mbajtën mbledhjen para dyerve të Kuvendit, sepse policia kishte bllokuar hyrjen. Në këto kushte, më 2 korrik 1990, në Prishtinë, Kuvendi i Kosovës shpalli Deklaratën Kushtetuese, të cilën e nënshkruan të gjithë delegatët e pranishëm. Deklarata Kushtetuese u miratua në bazë të së drejtës sovrane të popullit të Kosovës, duke përfshirë edhe të drejtën për vetëvendosje. Ajo është hartuar në 6 pika dhe ka përfshirë esencën e mendimeve për bërjen e Kosovës republikë dhe subjekt të barabartë me republikat konstituive të deriatëhershme të Federatës Jugosllave. Ato pika do t'i paraqesim në formë më të shkurtër, por duke ruajtur thelbin e tyre, si:

- Deklarata shpall përcaktimin burimor kushtetues të popullatës kosovare si akt i Kuvendit për vetëvendosje politike;

- Kuvendi e shpall Kosovën si njësi të barabartë në Jugosllavi, si vullnet njerëzor dhe nacional;

- Kosova përcaktohet si bashkësi kushtetuese-politike e nacionaliteteve të barabarta të Kosovës dhe shqiptarët konsiderohen KOMB e jo kombësi;

- Me Deklaratën bëhet shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Kosovës i 23 marsit të vitit 1989, për dhënien e pëlqimit në ato amendamente;

- Kuvendi i Kosovës, deri në aprovimin e Kushtetutës së re të Kosovës, do të komunikojë vetëm me emrin KOSOVË dhe

- Deklarata hyn në fuqi menjëherë¹⁴.

Pas miratimit të Deklaratës Kushtetuese, Kuvendi i KSA të Kosovës shpalli shkëputjen nga RS e Serbisë. Fillon simbolikisht periudha e pavarësisë së Kosovës. Kuvendi i Serbisë, me qëllim që të pengojë punën e mëtejme të pavarësisë të strukturave politiko-shtetërore të Kosovës, më 5 korrik, miratoi vendimin për vendosjen e masave të veçanta në Kosovë. Me këtë vendim u anuluan të gjitha organet legjitime institucionale dhe shtetërore të Kosovës. Zbatimin e tij e bënë forcat

¹⁴ “Fletorja zyrtare e KSAK”, nr.010-22/90. Deklarata është botuar në shumë gazeta dhe revista, në dokumente të Kuvendit të Kosovës në vitet në vijim dhe është komentuar edhe nga shumë punëtorë shkencorë.

policore dhe ushtarake jugosllave. Ky ishte rasti i parë që Armata Jugosllave vepronte nën urdhërat e një republike, pa një vendim të qeverisë Federale, por nuk do të ishte rasti i fundit. Ky veprim synonte të okupoheshin, pezulloheshin e të tjetërsoheshin organet shtetërore, administrata dhe institucionet e tjera ekonomike dhe joekonomike. Kjo ishte një ndër goditjet më të rënda për popullin shqiptar të Kosovës. Kuvendi i Serbisë mori vendim të posaçëm për pezullimin e Kryesisë së Kosovës, Kuvendit të Kosovës, Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës dhe administratës, bashkë me resorët politikë të tij. Largohen nga puna me dhunë policore të gjithë funksionarët, ekspertët dhe punëtorët shqiptarë. Ndërsa një numër punëtorësh largohet si tepricë teknologjike, në vendet e tyre të punës u sollën punëtorë serbë jo vetëm nga Kosova, por edhe nga viset e tjera të Serbisë. Njëherazi, okupohen dhe tjetërsohen të gjitha mjetet e informimit, si: Radio-televizioni i Prishtinës, duke u larguar nga puna me dhunë policore të gjithë punëtorët dhe ekspertët; okupohet dhe pezullohet redaksia e gazetës së përditshme “Rilindja” bashkë me të gjitha gazetatat dhe revistat e saj, me shtypshkronjën “Rilindja” dhe ndërmarrjen tregtare të saj, e cila e furnizonte ndërmarrjen në tërësi, u pezulluan dhe u okupuan edhe të gjitha gazetatat dhe revistat e ndërmarrjeve ekonomike dhe të institucioneve shoqërore.

Serbia bëri tjetërsimin dhe integrimin e dhunshëm të ekonomisë dhe të joekonomisë të Kosovës me ato të Serbisë. Serbia kishte miratuar Ligjin për veprimin e organeve republikane në rrethana të posaçme¹⁵. Ligji sajonte mundësi për të nxjerrë vendime të përkohshme, por ato u bënë të përhershme. Në bazë të këtij ligji si dhe masave të përkohshme u bë administrimi i dhunshëm në 150 ndërmarrje ekonomike dhe joekonomike, ndër më të rëndësishmet e Kosovës. Vetëm gjatë vitit 1990 dhe fillimit të vitit 1991 mbetën pa punë mbi 100 mijë punëtorë shqiptarë. Me këte u krijua mundësia që me dhunë të bëhej integrimi i ndërmarrjeve të Kosovës me ato të Serbisë.

Serbia bëri okupimin e të gjitha institucioneve të kulturës dhe të arsimit shqiptar. Kjo ishte edhe një nga goditjet më të rënda për popullin shqiptar, sepse me masa të përkohshme në Universitetin e Prishtinës, në shkollat e mesme, konviktet e studentëve dhe të nxënësve si dhe në të gjitha shkollat fillore, që deri në atë kohë kishin punuar të përziera me

¹⁵ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë”, 26 maj 1990, nr.30.

serbë, u vendosën masa të dhunshme. Të njëjtin fat e patën edhe institucionet e kulturës si: Biblioteka Popullore dhe Universitare bashkë me të gjitha bibliotekat nëpër komuna dhe institucione të tjera. Kështu ndodhi edhe me spitalet jo vetëm në Prishtinë, por edhe nëpër qendrat e tjera të Kosovës.

Kuvendi i Serbisë kishte miratuar vendimin edhe për plaçkitje të pasurisë së Kosovës dhe ne po i përmendim vetëm disa forma si: plaçkitja e mjeteve në dinarë dhe në deviza të Bankos-it, ku ishin edhe deponimet e qytetarëve; plaçkitja e depozitave të shqiptarëve në bankat e tjera, por edhe në bankat e ndërmarrjeve ekonomike si edhe kapitali i tyre. Njëherit u plaçkitën edhe mjetet e grumbulluara të qytetarëve për rikonstruimin e Televizionit të Prishtinës, si dhe ndihmat e grumbulluara që iu dedikoheshin xehtarëve të Kosovës. Llogaritet se vetëm gjatë vitit 1990 në këtë mënyrë janë plaçkitur më shumë se 5 miliardë dollarë. Nga kjo rezulton se shqiptarët përkundër të gjitha vështirësive, vendosën që të vijojnë punën me sistemin paralel të formimit të të gjitha strukturave politike dhe shtetërore. Kështu, Bashkësia Krahinore e Arsimit miratoi planet dhe programet mësimore për shkolla fillore dhe të mesme. Serbia, për të penguar këtë masë të shqiptarëve ndaloi financimet dhe i detyroi të largohen nga objektet shkollore. Edhe në këtë masë, shqiptarët nuk u dorëzuan dhe organizuan procesin mësimor nëpër shtëpi private. Edhe në këtë rast u gjet përkrahja e popullit si për vendosjen e ambienteve shkollore nëpër shtëpitë e tyre, ashtu edhe në sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme. Arsimitarët vendosën të punojnë edhe pa pagesë.

Delegatët e Kuvendit të Kosovës, pas miratimit të Deklaratës Kushtetuese, formuan grupet e punës për hartimin e Kushtetutës së Kosovës. Pas kësaj u thirr mbledhja e Kuvendit të Kosovës më 7 shtator të vitit 1990 dhe miratua Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji për zbatimin e Kushtetutës së Kosovës. Miratimi i Kushtetutës së Kosovës ishte një akt madhor. Mbledhja e Kuvendit të Kosovës u mbajt në Kaçanik, ndaj dhe kjo kushtetutë u bë e njohur si Kushtetuta e Kaçanikut. Kushtetuta hapi rrugën për formimin e organeve legjislative dhe ekzekutive të Kosovës. Pra Kuvendi i Kosovës nxori Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ajo u hartua në baza demokratike e shpreh aspiratat shekullore të popullit shqiptar. Qëllimi i kësaj kushtetute ishte mbrojtja kombëtare shqiptare dhe shpallja e shtetësisë së Kosovës e me këtë, fitimi i lirisë dhe i barazisë, siç e gëzonin popujt e tjerë të Jugosllavisë. Pas kësaj, pushteti shtoi edhe më shumë ndjekjen e popullit shqiptar. Delegatët u detyruan të

largohen nga territori i Kosovës. Disa prej tyre u burgosën. Po kështu ndodhi edhe me disa anëtarë të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës. Në Kaçanik u miratua edhe Rezoluta e Kaçanikut, e cila është me rëndësi të veçantë¹⁶. Në Rezolutë kërkohet përkrahja e shteteve sovraane të Evropës dhe të botës.

Delegatët e Kuvendit të Kosovës nga Kaçaniku shkuan në Shkup dhe prej andej në Zagreb, ku i priti dhe i përkrahu diaspora shqiptare e Kroacisë. Ata u kujdesën për sigurimin e mjeteve financiare dhe për të gjitha kushtet e nevojshme për vijimin e punës për veprimtari politike, por edhe për sigurimin e tyre nga rrëmbimet e mundshme të Sigurimit Shtetëror të Serbisë. Posaçërisht u angazhuan kolonel Tomë Berisha, Hakif Hamiti, Bedri Selmani dhe shumë të tjerë.

Mjetet e informimit të Evropës informuan për mbledhjen e Kuvendit të Kosovës në Kaçanik dhe për shpalljen e miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Serbia u informua për mbledhjen e Kuvendit të Kosovës dhe për largimin e delegatëve nga Kosova. Me qëllim që të frikësonte popullin shqiptar të Kosovës ndërmori aksione masakrimi dhe vrasjeje. Kështu, pas përgatitjeve të nevojshme vendosi që të sulmohej familja Monolli e Pollatës, komuna e Besianës¹⁷. Për këtë ishte hartuar plani i koduar me emrin “MUNJA”, në shqip “VETËTIMA”. Ekspedita ushtarako-policore e kombinuar me tanke dhe me mjete të blinduara, kishte qindra ushtarë dhe policë, të prirë nga

¹⁶ Në Rezolutë thuhet: “Duke u nisur nga e drejta e vetëvendosjes, duke respektuar vullnetin sovran të popullit shqiptar, të shprehur në mënyrë plebishitare në tërë Kosovën, lidhur me subjektivitetin politik-juridik dhe formimin e realizimit të atij subjektiviteti, të shprehur në Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut të vitit 1990, Kuvendi i Kosovës, në mbledhjen e përbashkët të tri dhomave, të mbajtur më 7 shtator 1990, në Kaçanik, aprovoi dhe shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës me të gjitha dokumentet përcjellëse dhe nxori Ligjin për bashkimin politik dhe bashkimin tjetër të qytetarëve, Ligjin për zgjedhjet, si dhe nxori vendime të tjera të nevojshme për punën e Kuvendit të Kosovës...”. Dokumenti është botuar bashkë me Kushtetutën e Kaçanikut, botim i veçantë dhe për herë të parë, Zagreb, 1990.

¹⁷ Familja Monolli është një nga familjet e njohura atdhetare në thellësi të historisë. Në veçanti ishin të njohur në luftë kundër robërisë serbe gjatë gjithë shek.XX. Nga kjo familje kishte shumë të burgosur politikë dhe shumë prej tyre ishin edhe organizatorë të demonstratave që nga viti 1981. Për qëndresë u dallua Hashim dhe Muhamet Latifi (Monolli), më vonë komandant i Brigadës së Mbrojtjes Civile gjatë luftës së UÇI-së në Zonën Operative të Llapit.

oficeri Zoran Paunoviq. Operacioni u krye natën e 13 shtatorit të vitit 1990 ku mbetën të vrarë Besim Latifi dhe Skënder Monoli, kurse 34 anëtarë të familjeve të tyre, në mëngjes, u arrestuan dhe u dërguan në burgun e Prishtinës, me gra dhe fëmijë.

Gjatë vitit 1990 janë vrarë nga policia serbe 39 veta dhe janë plagosur qindra të tjerë. Plaçkitjet dhe bastisjet ndaj shqiptarëve ishin në pakufi. Përkundër këtyre masave të rënda ndëshkuese shqiptarët treguan vendosmëri. Në vitet në vijim qëndresa gjithëpopullore u shtua deri në çlirimin nga Serbia.

